

20131704137

LIGJ PËR HUAMARRJE TË SHA MEPSO TE BANKA EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM SIPAS MARRËVESHJES PËR HUA PËR PROJEKTIN "REVITALIZIMI DHE MODERNIZIMI I RRJETIT PËRÇUES DHE UDHËHEQJA ME SISTEMIN ELEKTROENERGJETIK" PA GARANCI SHTETËRORE

Neni 1

SHA MEPSO ngarkohet me hua te Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim në shumë prej 25 000 000 eurosh, të dedikuar për projektin "Revitalizimi dhe modernizimi i rrjetit përçues dhe udhëheqja me sistemin elektroenergjetik".

Neni 2

Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të huas nga neni 1 i këtij ligji përcaktohen me Marrëveshjen për hua për projektin "Revitalizimi dhe modernizimi i rrjetit përçues dhe udhëheqja me sistemin elektroenergjetik", që do të lidhet ndërmjet SHA MEPSO te Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

Në emër të SHA MEPSO, Marrëveshjen për hua nga paragrafi 1 i këtij neni do ta nënshkruajë drejtori i SHA MEPSO.

Neni 3

Afati i pagesës së huas nga neni 1 i këtij ligji është 15 vite, me grejs periudhë të përfshirë prej tri vitesh.

Shkalla e kamatës është e barabartë me EURIBOR gjashtëmujor e rritur për 3% në nivel vjetor.

Huaja do të paguhet 12 vite në çdo 20 qershor dhe 20 dhjetor.

SHA MEPSO i paguan Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim provizion të njëhershëm në shumë prej 190 000 eurosh.

Për shumën e mjeteve të patërhequra të huas nga neni 1 i këtij, ligji Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim i paguhet provizion në nivel vjetor në shumë prej 0,5% të shumës së mjeteve të patërhequra të huas.

Për obligimet lidhur me huan nga neni 1 i këtij ligji që nuk do të paguhet në afatet e parapara, do të paguhet kamatë ndëshkuese në lartësi të shkallës së kamatës nga paragrafi 2 i këtij neni të rritur për 2% në nivel vjetor.

Neni 4

SHA MEPSO huan nga neni 1 i këtij ligji e paguan nga mjetet e veta.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".